



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 1.3.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTVENDIMIN E KUVENDIT “PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR 2019 PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2017-2021”

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 1 mars 2019, shqyrtoi projektvendimin e Kuvendit “Për miratimin e planit vjetor 2019 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektvendim sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore për këtë projektvendim deputeten Blerina Gjylameti.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të paraqitur projektvendimin dhe për të dhënë sqarimet e kërkuara nga deputetët, disa drejtorë të drejtorive të Institutit të Statistikave, të cilët mbulojnë fushat e koordinimit dhe çështjeve ligjore, sektorit real, llogarive kombëtare, statistikave ekonomike, si dhe koordinimit dhe planifikimit.

- ***Baza ligjore e projektvendimit.***

Projektvendimi është përgatitur nga INSTAT dhe është paraqitur në Kuvend nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat nenit 9 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”. Kuvendi miraton planin vjetor brenda një muaji nga data e paraqitjes së tij nga Këshilli i Ministrave. Miratimi i këtij projektvendimi kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektvendimit.***

Qëllimi i projektvendimit është përcaktimi i aktiviteteve statistikore dhe treguesve statistikorë që do të prodhohen nga Sistemi Kombëtar Statistikor për vitin 2019.

Projektplanin vjetor 2019 përgatitet për herë të parë në vendin tonë, mbështetur në kërkesat e ligjit, Programin e Statistikave Zyrtare dhe standardet që dalin nga Rregullorja (KE) 223/2009 “Për statistikën evropiane”. Sistemi Kombëtar Statistikor përbëhet nga tërësia e institucioneve që mbledhin, përpunojnë e publikojnë statistika zyrtare. Aktualisht, këto institucione janë INSTAT, Banka e Shqipërisë, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ligji për statistikën zyrtare ngarkon INSTAT të udhëheqë Sistemin Kombëtar Statistikor dhe të koordinojë veprimtarinë e tij në termat e planifikimit, monitorimit dhe raportimit periodik pranë Kuvendit për ecurinë e prodhimit statistikor. Koordinimi kryhet edhe për të siguruar që të gjithë prodhuesit e statistikave zyrtare përdorin standardet, konceptet, përkufizimet, klasifikimet dhe metodologjitë statistikore të miratuara nga institucionet ndërkombëtare.

Projektplanin vjetor përmban:

- Aktivitetet statistikore që do të kryhen gjatë vitit 2019;
- Institucionet përgjegjëse për prodhimin e statistikave zyrtare;
- Institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit të nevojshëm për prodhimin e statistikave zyrtare;
- Afatet e përbushjes së aktiviteteve statistikore;
- Risqet dhe problemet e pritshme për kryerjen e aktiviteteve statistikore.

- ***Efektet financiare të projektvendimit.***

Projektvendimi nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e vitit 2019. Të ardhurat për kryerjen e aktiviteteve të planit Vjetor 2019 janë parashikuar në buxhetin e vitit 2019 të INSTAT-it, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.

- ***Diskutimi në Komision.***

Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore në INSTAT paraqiti një informacion mbi përmbajtjen e Projektplanit Vjetor 2019 të INSTAT, si dhe arsyet dhe rëndësinë e miratimit të tij.

Relatorja paraqiti një informacion mbi nevojën dhe bazën ligjore të projektvendimit, si dhe çështjet kryesore të trajtuara në projektplanin vjetor. Më tej, ajo u ndal në realizimin e deritanishëm të

Programit të Statistikave Zyrtare, si dhe objektivat e INSTAT-it për vitin 2019, për të arritur realizimin me sukses të planit për këtë vit, si më poshtë:

Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021 ka përcaktuar strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe të Sistemit Kombëtar Statistikor për periudhën pesëvjeçare si dhe aktivitetet statistikore që do të kryejnë institucionet e sistemit gjatë kësaj periudhe. Ai ka përcaktuar disa objektiva kryesore, në drejtim të harmonizimit të kuadrit ligjor me atë të BE-së; përmirësimit të cilësisë së statistikave; zhvillimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të strukturave të prodhimit statistikor; rritjes së rolit të përdoruesve në proceset e aktiviteteve statistikore; përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstitutional; zhvillimit të proceseve të shpërndarjes së statistikave, si dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, për të rritur kapacitetet profesionale të statisticienëve.

Gjatë viteve 2017-2018 në sistemin statistikor kombëtar kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme. Raporti i Progresit i Komisionit European vlerësoi se Shqipëria ka bërë përparime jo vetëm në fushat statistikore, por edhe në formalizimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor. INSTAT ka përmirësuar fushën dhe cilësinë e statistikave që boton. Raporti vlerëson miratimin në shkurt 2017 të Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021, si dhe rekomandon miratimin e planit vjetor. INSTAT ka bërë marrëveshje me poseduesit e të dhënave për të siguruar akses në të dhënat administrative, me qëllim lehtësimin e përdorimit për arsye statistikore të këtyre të dhënave.

Në verën e vitit të kaluar Eurostat kreu në Shqipëri vlerësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor (procesi Peer Review) nga një ekip vlerësues prej tre ekspertësh të huaj. Pasi zhvilloi takime me përfaqësuesit e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare, institucioneve furnizuese me të dhëna administrative, përdoruesve të statistikave, medias dhe organizatave ndërkombëtare, në nëntor publikoi raportin final të vlerësimit. Raporti final Peer Review gjendet në faqen e Eurostat dhe INSTAT. Ai pasqyron nivelin e zbatimit të parimeve statistikore europiane, si dhe propozon aktivitete përmirësuese për çdo parim statistikor të parashikuar në nenet 4 dhe 5 të ligjit për statistikat zyrtare.

Një pjesë e këtyre aktivitete do të përmbushen gjatë vitit 2019 dhe janë përfshirë në planin operacional të INSTAT-it.

Disa nga zhvillimet kryesore në vitin 2018 janë:

- Miratimi në prill të vitit 2018 i ligjit të ri për statistikat zyrtare, i cili ishte një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me standardet europiane. Përparësitë që solli ligji ishin forcimi i pavarësisë profesionale të INSTAT, forcimi i rolit udhëheqës të INSTAT në prodhimin e statistikave zyrtare, forcimi i mandatit të prodhuesve statistikorë për të drejtën e hyrjes në të dhënat administrative, si dhe zgjerimi i autonomisë së INSTAT për administrimin dhe përdorimin e burimeve të veta.

- Gjatë vitit 2018 INSTAT u fokusua në fillimin e punëve përgatitore për Censin e ardhshëm të Popullsisë e Banesave. Për këtë qëllim, u përgatit projektligji për Censin e Popullsisë dhe Banesave, si dhe drafti i parë i pyetësorit të Censit, i cili do t'i nënshtrohet më tej pilotimeve dhe konsultimeve të tjera.
- Ndikim të rëndësishëm pati edhe kontributi i INSTAT për ngritjen e Qendrës së Trajnimit Statistikor, për të hartuar plane mbi rritjen e kapaciteteve profesionale të statisticienëve.
- Në vitin 2018 u vendos në funksion sistemi i përdorimit të kohës, i cili ka për qëllim matjen me efikasitet të kostos së produkteve statistikore.

Viti 2019 përmban disa detyrime për INSTAT, si:

1. Zbatimin e projektit pilot për censin e popullsisë dhe banesave 2020;
2. Implementimin e strukturës së re organizative të INSTAT;
3. Fillimin e punës për Auditimin Statistikor etj.

Disa nga objektivat kryesore të parashikuara për vitin 2019 janë:

1. Implementimi i Softit të Burimeve Njerëzore dhe Platformës Intranet;
2. Hartimi i strategjisë për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;
3. Prodhimi i statistikave sa më cilësore, të kuptueshme dhe të besueshme për përdoruesit;
4. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodologjive, duke i harmonizuar me rregulloret dhe standartet ndërkombëtare;
5. Shtimi i numrit të produkteve statististikore;
6. Shtimi i treguesve statistikorë;
7. Shtimi dhe përmirësimi i treguesve në nivel vendor;
8. Rritja e burimeve të informacionit;
9. Reduktimi i afateve kohore të publikimeve;
10. Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike;
11. Rritja e numrit të të dhënave të transmetuara në Eurostat, si risi që do të rrisë nivelin e përputhshmërisë me standartet evropiane.

Me qëllim zgjerimin e të dhënave të disponueshme për përpunim statistikor si dhe numrin e treguesve statistikorë, gjatë vitit 2019 do të zhvillohen disa anketa të reja si: ajo e Strukturave Akomoduese, Anketa Prodcom, Inovacioni në ndërmarrje dhe anketa për Migracionin.

Gjithashtu, gjatë vitit do të kryhen disa publikime të reja si: Inventari i Mjeteve të Transportit Rrugor, Publikimi i Rezultateve Kryesore të Anketave pranë Familjeve, Publikimi i Rezultateve Kryesore të

Llogarive Kombëtare. Publikimi i rezultateve do të shoqërohet edhe me aktivitete prezantuese që do të kryejë INSTAT, si: konferenca, workshope etj.

Censi i ardhshëm i Popullsisë dhe Banesave është aktiviteti kryesor që do të zbatojë INSTAT brenda dy viteve. Për këtë arsye, në aktivitetet e planifikuara për vitin 2019 përfshihen kryerja e Pilotit të Censit (i parashikuar për muajin tetor). Natyra e këtij aktiviteti është një Cens në terma të zvogëluar, ku do të testohen të gjitha fazat e tij. Ndër më kryesorët përmenden: përditësimi në terren i 11,775 zonave të censit, përditësimi i teknologjisë GIS, organizimi dhe realizimi i trajnimit të anketuesve; përditësimi dhe përmirësimi i bazës së të dhënave të INSTAT-it (adresat, emrat e rrugëve, pikat e interesit dhe të tjera të dhëna hapësinore), zhvillimi i testimeve të sistemeve TI për pyetësin elektronik si edhe sistemit të monitorimit të procesit në terren. Piloti do të jetë momenti kyç për testimin e sistemeve në tërësi, si dhe përditësimin e përmirësimin e tyre, si pasojë e gjetjeve të tij, me qëllim që të përgatitet një infrastrukturë sa më efiçiente për Censin e Popullsisë dhe Banesave.

- ***Përfundim.***

Si konkluzion, projektplanin e statistikave zyrtare për vitin 2019 është detyrim që rrjedh nga ligji për statistikën zyrtare, Programi i Statistikave Zyrtare dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare. Ai është hartuar në përputhje me këto dokumente. Për këto arsye, Komisioni e miratoi projektvendimin e Kuvendit për miratimin e këtij projektplanin me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORJA

Blerina GJYLAMETI

KRYETARI

Arben AHMETAJ